



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



Save the Children



Tiranë, më 20/09/2018

Thirrje për shprehje interesi për të marrë pjesë në aktivitetin:

WORKSHOP PËR NDËRMJETËS DHE LEHTËSUES TË PROCESVEVE RESTAURUESE

Në datë 4 Tetor 2018, organizohet në Tiranë, në mjediset e Hotel Mondial, një workshop njëditor për ndërmjetës dhe lehtësues të proceseve restauruese me tematikë: “Shmangia, drejtësia restauruese dhe ndërmjetësimi - Si të drejtojmë me efektivitet një proces restaurues”

Workshopi organizohet në kuadër të projektit "Mbështetje për të miturit viktime dhe kundërvajtës përmes drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit" që zbatohet nga Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve, si pjesë e skemës së granteve të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendrën e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Qëllimi i workshop-it është rritja e kapaciteteve dhe aftësive ndërmjetësuese dhe lehtësuese, veçanërisht në rastet ku janë të përfshirë të miturit në kontakt me ligjin, si dhe njohja me kuadrin e ri ligjor për të miturit.

Në workshop do të marrin pjesë rreth 20 ndërmjetës nga rrethet Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë dhe Elbasan, ku dhe zbatohet projekti.

Të interesuarit janë të lutur të paraqesin kërkesën e tyre nëpërmjet e-mailit, duke shpjeguar motivimin për të marrë pjesë, në adresën mediationalb@abcmail.al (cc: m_xhediku@yahoo.com) brenda datës 28 shtator 2018. Personat e përzgjedhur do të njoftohen brenda datës 1 Tetor 2018.